



Subjekti Politik

**Nova Demokratska Stranka
(NDS)**

Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorit të pavarur

01 Janar 2023 - 31 Dhjetor 2023

Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur..	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	5
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	6
Informata të përgjithshme	7
Shënimet e pasqyrave financiare.....	8 - 13

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë se subjektit politik Nova Demokratska Stranka

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar raportet financiare bashkëngjitura të Subjektit Politik “Nova Demokratska Stranka” (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “NDS”), te përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2023, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë date, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në fq 8-13.

Sipas mendimit tonë, me përjashtim të efekteve për çështjet e përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin të kualifikuar të raportit tonë, Pasqyrat Financiare të bashkëngjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit Politik me datën 31 Dhjetor 2023, dhe të Hyrat dhe Shpenzimet për periudhën, në pajtim me me Ligjin 08/L-122 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-212 dhe me ligjin Nr.04/L-058.

Bazat për Opinion te kualifikuar

- Ashtu sic eshte shpalosur ne shenimin 8 Detyrimet tjera afatshkurtra, Subjekti Politik për vitin 2022 ka prezentuar detyrimet tjera afatshkurtra në vlerën prej 3,103.04 euro. Gjate auditimit ton ne kemi konstatuar që këto detyrime kanë qenë të mbivlersuara për 1,564.10 euro.
- Gjatë auditimit ton ne kemi konstatuar që tatimi mbajtur në burim për qira është nënvlerësuar dhe nuk janë deklaruar ne përputhje me kërkesat e Ligjit 06/L-105 paragrafi 3.

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit ne paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Subjekti politik në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Theksim i çështjes

Pa dashur që theksimi i çështjeve të ndikoj edhe më tej në kualifikimin e opinionit tonë, ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme si:

- Subjekti Politik nuk e ka te definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet në ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- SP "Nova Demokratska Stranka" nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet të mirëfilltë për të mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen në çdo kohe të pasqyrave financiare sipas Standardeve të Kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Gjatë testimit të shpenzimeve janë prezantuar faturat e shpenzimeve por mungojnë dëshmit me dokumentacion mbështetës për aktivitetet që i ka realizuar SP.

Çështje tjera

Pasqyrat financiare të subjektit politik për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2022 janë audituar nga auditor tjetër opinionin i të cilëve mbi këto pasqyra ka qenë i pa kualifikuar.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre te ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin 08/L-122 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-212 dhe me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë. Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijmësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Fatmir Mehmeti
Auditor Ligjor
21 Qershor 2024

Subjekti Politik Nova Demokratska Stranka

Pasqyrat Financiare 01 Janar 2023 deri më 31 Dhjetor, 2023

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2023	Me 31 Dhjetor 2022
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	5	0.00	0.00
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Total pasuritë afatgjata		0.00	0.00
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme		0.00	0.00
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	0.00	0.00
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Total pasuritë afatshkurtra		0.00	0.00
Total pasuritë		0.00	0.00
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		(1,564.10)	
Suficiti / (deficiti) i vitit		1,438.58	(1,564.10)
Total Ekuiteti		(125.52)	(1,564.10)
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyera	5	0.00	0.00
Gjithsej detyrimet afatgjata		0.00	0.00
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8	0.00	0.00
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra	9	125.52	1,564.10
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		125.52	1,564.10
Gjithsej detyrimet		125.52	1,564.10
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		0.00	0.00

Subjekti Politik Nova Demokratska Stranka*Pasqyrat Financiare 01 Janar 2023 deri më 31 Dhjetor, 2023***Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve**

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2023	2022
Të hyrat			
Të hyrat nga buxheti		35,000.00	35,000.00
Të hyrat nga anëtarësia			
Donacionet dhe kontributet në të holla	3	0.00	19.20
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4		
Të hyrat e fushatës			
Te hyrat e liruar nga te hyrat e shtyera	5		
Të hyrat tjera			
Gjithsej të hyrat për vitin		35,000.00	35,019.20
Shpenzimet			
Pagat dhe kompensimet	2	11,021.72	10,531.80
Shpenzimet e transportit	2	1,722.20	1,520.00
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2	16,468.90	18,674.90
Shpenzimet e fushatës	2	0.00	0.00
Blerja e mallrave	2	72.70	1,148.75
Shpenzimet e përgjithshme	2	3,948.90	4,371.17
Shpenzimet e ndryshme	2	327.00	336.68
Gjithsej shpenzimet për vitin		33,561.42	36,583.30
Suficiti / (deficiti) për vitin		1,438.58	(1,564.10)

1. Informata te përgjithshme

NOVA DEMOKRATSKA STRANKA-NDS

Nova Demokratska Stranka është themeluar më datën 07.04. 2009

Kryetari i Nova Demokratska Stranka për vitin 2023 është : znj. Elmija Regjepi

Zyrtar financiar : Almir Saiti

Pasqyrat financiare te NOVA DEMOKRATSKA STRANKA-NDS janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-212 dhe me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 10 te Ligjit 08/L-122 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-212 dhe me ligjin Nr.04/L-058 , Subjekti i regjistruar politik brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga marrja e rezultateve preliminare të kontrollimit mund ta dorëzojë raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimin lidhur me çdo gabim të dukshëm ose lëshim të identifikuar nga auditorët. Mosrespektimi i këtij afati nënkupton pajtimin me të gjeturat e auditorit.

Subjekti Politik mirëmban llogari kryesore bankare ne bankën ProCredit Bank

Subjekti Politik Nova Demokratska Stranka

Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2023 deri më 31 Dhjetor, 2023

Shënimi 2. Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto	9,450.00	10,450.00	(1,000.00)
Kontributet pensionale të punëmarrësit	424.06	549.02	(124.93)
Kontributet pensionale të punëdhënësit	424.06	549.02	(124.93)
Tatimet në të ardhura personale	723.55	995.10	(271.55)
Beneficionet tjera			
Gjithsej	11,021.72	12,543.13	(1,521.41)
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara			
Karburantet	1,502.20	1,502.20	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.			
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave			
Çdo shpenzim tjetër i transportit	220.00	220.00	0.00
Gjithsej shpenzimet e transportit	1,722.20	1,722.20	0.00
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali			
Ushqimi	10,846.80	10,846.80	0.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative			
Radio dhe spotet televizive			
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta	4,222.10	4,222.10	0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	1,400.00	1,400.00	0.00
Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	16,468.90	16,468.90	0.00
Shpenzimet e fushatës			
Shpenzimet e fushatës			
Gjithsej shpenzimet e fushatës			

Subjekti Politik Nova Demokratska Stranka

Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2023 deri më 31 Dhjetor, 2023

Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës	72.70	72.70	0.00
Pajisjet të vogla			
Gjithsej blerja e mallrave	72.70	72.70	0.00
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës	3,536.38	3,579.07	(42.69)
Telefoni, interneti dhe posta			0.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	412.52	287.00	125.52
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	0.00	////////////////////	////////////////////
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime		////////////////////	////////////////////
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	3,948.90	3,866.07	82.83
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës			
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	327.00	327.00	0.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	327.00	327.00	0.00
Gjithsej shpenzimet	35,125.52	35,000.00	(1,438.58)

Subjekti Politik Nova Demokratska Stranka*Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2023 deri më 31 Dhjetor, 2023***Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla**

Pranuar nga				Vlera	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro	Bankë	Arkë
Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla				0.00	0.00	0.00

Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga				Vlera
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro
Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime					0.00

Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fund të vitit (vlera neto)
Toka					
Objektet					
Veturat					0.00
Pajisjet e zyrës					0.00
Pajisjet e teknologjisë informative					0.00
Pajisjet tjera					0.00
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00

Shënime tjera

Subjekti Politik Nova Demokratska Stranka*Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2023 deri më 31 Dhjetor, 2023*

Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme	Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro
Gjithsej Llogarit e arkëtueshme	0.00	0.00

Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë	Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro
Paraja në bankë		
Paraja në arkë		
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	0.00	0.00

Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro
Te pagueshme ndaj furnitoreve		
Llogari të pagueshme të tjera		
Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera	0.00	0.00

Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra	Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime	0.00	1,000.00
Detyrimet për qira	0.00	42.69
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime		
Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet)	125.25	521.41
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra	125.25	1,564.10

Subjekti Politik Nova Demokratska Stranka

Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2023 deri më 31 Dhjetor, 2023

Shënimi 10: Pagesat mbi 5,000.00 Euro

Qëllimi i pagesës	Paguar ndaj:			Data kur është bërë pagesa	Vlera
	Përsoni Fizik/Juridik	Adresa	Numri personal		në euro
Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro					0.00